



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 22

Tiranë – E premte, 20 shkurt 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 11.2.2015	Për lirim nga detyra..... 1159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 11.2.2015	Për emërim në detyrë..... 1159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 11.2.2015	Për propozimin, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të një anëtari për në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 1159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 11.2.2015	Për emërimin në detyrë të një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik..... 1159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 11.2.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 7, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, të ndryshuar..... 1159
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 11.2.2015	Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 1160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.2.2015	Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura..... 1160
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 11.2.2015	Për caktimin e disa anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit..... 1165
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 11.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Komuna e Parisit - Rruga e Re Tiranë - Elbasan”..... 1166
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 11.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë - Elbasan”(shtesa)..... 1167

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 11.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (lotet I dhe III).....	1171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 11.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Tepelenë (shtesa).....	1174

**VENDIM****Nr. 118, datë 11.2.2015****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Sokol Dervishaj, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 119, datë 11.2.2015****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Selim Belortaja emërohet zëvendësministër i Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 120, datë 11.2.2015**

**PËR PROPOZIMIN, KUVENDIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË NJË  
ANËTARI PËR NË KËSHILLIN  
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË  
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Propozimin, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të znj. Denada Prifti për anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 121, datë 11.2.2015**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË  
NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË  
PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19/2, pika 2, e 19/5, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Hektor Balluku emërohet anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 123, datë 11.2.2015**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN  
NR. 7, DATË 4.1.2012, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E  
PROCEDURAVE DHE  
DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM  
PËR ARKËTIMIN E TAKSËS SË RENTËS  
MINERARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

Në fund të pikës 3, të vendimit nr. 7, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në varësi të përqindjes së mineralit të shitur brenda vendit, nga nxjerrësi i mineralit të përpunuesi/pasuruesi i mineralit, llogaritja e pagesës së rentës bëhet sipas çmimeve, të përcaktuara në tabelat referuese, të miratuara nga komisioni *ad-hoc*, i përcaktuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

## VENDIM

Nr. 124, datë 11.2.2015

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN  
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E  
PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, regjistrohen individët e renditur në shkronjën “a”, të listës, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**AZHURNIMI NË LISTËN E  
PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT  
SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË  
SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)**

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

- 1 ASHRAF; MUHAMMAD; YUSUF; ‘UTHMAN ‘ABD AL-SALAM
- 2 IBRAHIM; ‘ISA HAJJI; MUHAMMAD; AL-BAKR
- 3 TARKHAN; TAYUMURAZOVICH; BATIRASHVILI
- 4 ‘ABD AL-MALIK; MUHAMMAD; YUSUF; ‘UTHMAN ‘ABD AL-SALAM

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

## VENDIM

Nr. 127, datë 11.2.2015

**PËR KËRKESAT PËR PËRDORIMIN  
NË BUJQËSI TË LLUMRAVE TË  
UJËRAVE TË NDOTURA<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 34, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

<sup>1</sup> Direktiva 86/278/EEC “Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi” ndryshuar nga Direktiva 91/692/EEC, rregullorja (EC) 807/2003 dhe rregullorja (EC) 219/2009. Numri CELEX 1986L0278, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 181, datë 4.7.1986, faqe 6.



VENDOSI:

KREU I  
TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të rregullojë përdorimin korrekt në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura, duke nxitur ato mënyra që parandalojnë efektet e dëmshme në tokë, bimësi, kafshë dhe tek njerëzit.

2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Autoriteti kompetent” është Ministria e Mjedisit (MM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB);

b) “Bujqësi”, sipas përkufizimit në ligjin nr. 9717, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;

c) “Ekuivalent popullsie (p.e.)” është ngarkesa organike e biodegradueshme, që ka kërkesë biokimike pesëditore për oksigjen (BOD5), prej 60 g. oksigjen në ditë;

ç) “Impiant trajtimi i ujërave të ndotura” është njësi që trajton dhe pastron ujërat e ndotura me prejardhje nga përdorimi familjar dhe/ose industrial, me kapacitet total trajtimi më shumë se 500 PE, përfshirë dhe pjesën e fundit në derdhje të kolektorit të ujërave të ndotura;

d) “Impiant i vogël trajtimi i ujërave të ndotura” është impianti me kapacitet total trajtimi më pak se 500 PE;

dh) “Impiant individual ose lokal trajtimi i ujërave të ndotura” është grupa septike, grupa e ujërave të zeza, grupa e banjave, banja në oborr me gropë ose drenazhi francez, i cili shërben për trajtimin në vend të ujërave të ndotura, në zonat ku nuk ka sistem publik kanalizimesh;

e) “Llum” janë llumrat që mbeten nga:

i) impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, sipas përcaktimit në shkronjën “ç”;

ii) impiantet e vogla të trajtimit të ujërave të ndotura, sipas përcaktimit në shkronjën “d”;

iii) impiante individuale ose lokale të trajtimit të ujërave të ndotura, sipas përcaktimit në shkronjën “dh”.

ë) “Llumra të trajtuara” janë llumrat që i janë nënshtruar trajtimit biologjik, kimik ose trajtimit me nxehtësi, magazinimit afatgjatë ose ndonjë procesi tjetër të përshtatshëm, që redukton në mënyrë të konsiderueshme fermentimin e tyre dhe rreziqet për shëndetin, që vijnë si rezultat i përdorimit të tyre;

f) “Përdorim” është përhapja e llumrave mbi tokë, ose çdo përdorim tjetër i llumrave mbi ose në tokë;

g) “Prodhues” është operatori i impiantit që prodhon dhe/ose vendos në treg llumra të trajtuara për përdorim në bujqësi;

gj) “Përdorues” është personi fizik ose juridik që përdor llumrat e trajtuara, të cilat dalin nga të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

h) “Tokë bujqësore”, sipas përkufizimit në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;

i) “Ujëra të ndotura” janë ujëra të përdorura ose ujërat që përmbajnë lëndë të ngurta, nga përdorimet familjare, tregtare dhe industriale, të cilat janë ndotur dhe/ose u janë ndryshuar vetitë (ujëra të përdorura ose mbetje të lëngshme), si dhe lëngjet kulluese nga landfill-et sanitare, apo llumrat nga gropat septike;

j) “Ujëra të ndotura urbane”, sipas përkufizimit në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;

k) “Ujëra të ndotura industriale”, sipas përkufizimit në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

KREU II  
LLUMRAT

3. Përveç sa parashikohet në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, llumrat mund të përdoren në bujqësi vetëm në qoftë se janë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

4. Vlerat kufi të përqendrimit të metaleve të rënda në tokën ku janë përdorur llumrat, vlerat kufi të përqendrimit të metaleve të rënda në llumra dhe vlerat kufi për sasinë e metaleve të rënda që mund të futen çdo vit në tokën e parashikuar për bujqësi përcaktohen në anekset IA, IB dhe IC, që i bashkëngjiten këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

5. Llumrat nuk duhet të përdoren në tokat ku përqendrimi i një apo më shumë metaleve të



rënda i kapërcen vlerat kufi, të përcaktuara në aneksin IA, ose kur përdorimi i llumrave mund të sjellë kapërcimin e këtyre vlerave kufi.

6. Për qëllime të pikës 5, të këtij vendimi:

a) sasia maksimale e llumrave që mund të përdoret në tokë, e shprehur në ton, lëndë e thatë, për hektar, në vit, do të përcaktohet nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) pas konsultimeve të detyrueshme me Inspektoratin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës, rast pas rasti, duke pasur parasysh pozicionin gjeografik dhe karakteristikat e tokës, bazuar në rezultatet e analizave të tokës për metalet e rënda, që do të kryhen sipas kërkesave të aneksit IIB, që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi;

b) vlerat kufi, të përcaktuara për përqendrimin e metaleve të rënda në llumra, duhet të jenë në përputhje me vlerat e aneksit IA, që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

7. Përpara përdorimit të llumrave në tokë bujqësore:

a) llumrat analizohen, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin IIA;

b) toka analizohet, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin IIB;

c) analizat e kërkuara për qëllime të shkronjave “a” dhe “b” kryhen nga laboratorë të akredituar, duke përdorur metodat e analizave të përcaktuara në aneksin IIC, që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

ç) me përjashtim të rasteve kur llumrat përdoren në toka kullimore, mostrat duhet të merren në një thellësi prej 25 centimetrash ose, kur thellësia e sipërfaqes së tokës është më pak se kaq, të sigurohet që thellësia e sipërfaqes së tokës, për marrjen e mostrës, të mos jetë më pak se 10 centimetra;

d) kur llumrat përdoren në tokë kullimore, mostrat duhet të merren në jo më shumë se 6 centimetra thellësi.

### KREU III

#### DETYRIMET E PRODHUESIT

8. Prodhuesi i llumrave që përdoren në bujqësi duhet:

a) të pajiset me leje mjedisi, të tipit C, lëshuar në përputhje me aneksin 1, 6.4, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

b) të trajtojë llumrat;

c) t’u ofrojë rregullisht, përdoruesve, rezultatet e analizave të llumrave, të kryera periodikisht, në përputhje me aneksin IIA;

ç) të mbajë regjistrin me të dhëna, i cili të përfshijë:

i) sasinë e llumrave të prodhuara dhe sasinë e shpërndarë për përdorim në bujqësi;

ii) përbërjen dhe vetitë e llumrave, në lidhje me parametrat e referuar në aneksin IIA;

iii) trajtimin, të cilit i janë nënshtruar llumrat, duke pasur parasysh trajtimin referuar në shkronjën “b”;

iv) emrin dhe adresën e përdoruesit të llumrave dhe vendndodhjen e tokës ku përdoren llumrat.

d) të mbajë regjistrin me të dhëna në mjediset e tij të punës dhe ta bëjë atë të disponueshëm për informim, dhe pa pagesë, gjatë orarit zyrtar, për çdo person të interesuar;

dh) të raportojë, brenda datës 30 qershor, të çdo viti, pranë autoritetit kompetent, të dhënat e regjistruara.

9. Prodhuesi i llumrave të jetë i pajisur me lejen e mjedisit dhe me licencën III/2B, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Prodhuesi, me kërkesë të autoriteteve kompetente, duhet të japë informacion mbi metodat e trajtimit dhe rezultatet e analizave.

### KREU IV

#### DETYRIMET E PËRDORUESIT

11. Përdoruesi i llumrave në bujqësi detyrohet të:

a) analizojë tokën ku janë përdorur llumrat, në përputhje me aneksin IIB;

b) marrë parasysh nevojat e bimëve për lëndë ushqyese;

c) sigurojë që cilësia e tokës, e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të mos dëmtohet;

ç) marrë parasysh lëvizshmërinë dhe disponueshmërinë në rritje të metaleve të rënda në kulturat bujqësore, kur llumrat janë përdorur në një tokë me pH nën 6 dhe në përputhje me aneksin IA;

d) përdorë llumrat e ujërave të ndotura pasi të jetë pajisur me lejen e mjedisit dhe licencën III/2B, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) mbajë regjistrin me të dhëna, ku të përfshijë:

i) sasinë e llumrave të përdorur në bujqësi;



ii) sipërfaqen dhe vendndodhjen e tokës bujqësore ku janë përdorur llumrat;

iii) emrin dhe adresën e impiantit që ka prodhuar llumrat.

e) raportojë, brenda datës 30 qershor, të çdo viti, pranë autoritetit kompetent, të dhënat e regjistruara.

12. Përdoruesi i llumrave i njofton njësisë përkatëse të qeverisjes vendore vendndodhjen e tokës ku do të përdoren llumrat.

#### KREU V

### KËRKESAT PËR PËRDORIMIN DHE NDALIMIN E PËRDORIMIT TË LLUMRAVE TË TRAJTUARA NË BUJQËSI

13. Llumrat duhet të trajtohen përpara përdorimit në bujqësi. Nuk lejohet përdorimi i llumrave të patrajtuara.

14. Përveç sa parashikohet në pikën 13, përdorimi i llumrave të trajtuara në bujqësi nuk lejohet në këto raste:

a) kur mbetjet e llumrave vijnë nga impiantet individuale ose lokale të trajtimit të ujërave të ndotura, përveç se kur përdoren në toka kullimore, ku bagëtia nuk do të kullojë më parë se të kenë kaluar 6 muaj nga përdorimi i tyre;

b) në toka kullimore apo ku rriten bimë foragjere, në qoftë se tokat që përdoren për kullotë apo bimët foragjere do të korren brenda tri javëve nga përdorimi i llumrave.

#### KREU VI

### REGJISTRI KOMBËTAR PËR PËRDORIMIN E LLUMRAVE NË BUJQËSI

15. Autoriteti kompetent (AKM/QTTB) krijon, mban dhe përditëson Regjistrin Kombëtar për Përdorimin e Llumrave në Bujqësi, ku përfshihen të dhënat përkatëse, të raportuara nga prodhuesit dhe përdoruesit. Autoriteti kompetent (AKM/QTTB) i siguron Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve të dhënat e raportuara nga prodhuesit dhe përdoruesit për përditësimin e çdo regjistri ekzistues për ujërat dhe ujërat e ndotura.

16. Autoriteti kompetent (AKM/ QTTB) mban regjistrin, referuar në pikën 15, në selinë e tij dhe e bën të disponueshëm, pa pagesë, për çdo person të interesuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

17. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për bujqësinë miratojnë, me urdhër të përbashkët, formatin e regjistrave, të referuar në pikat “8/d, “11/P” dhe “15”, të këtij vendimi.

#### KREU VII

### RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

18. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për bujqësinë, me urdhër të përbashkët, miratojnë formatin që do të përdoret për përgatitjen e raportit dhe informacionin që do të përshihet në të.

19. Ministritë përgjegjëse për mjedisin dhe bujqësinë përgatisin, bashkërisht, raportin mbi zbatimin e këtij vendimi, brenda muajit qershor 2017, dhe çdo tre vjet për periudhën në vijim.

20. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Tokës dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, si dhe institucionet e tjera përkatëse, u sigurojnë ministrive informacionin e duhur për përgatitjen e raportit të sipërpërmendur.

21. Raporti, i referuar në pikën 19, publikohet në faqen zyrtare elektronike të ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe vihet në dispozicion të publikut.

#### KREU VIII

### DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

22. Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, me kapacitet trajtimi nën 300 kg. BOD5 në ditë, që i korrespondojnë 5000 p.e., të cilët janë projektuar kryesisht për trajtimin e ujërave të ndotura shtëpiake, përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të parashikuara në pikën 8, shkronja “a”, dhe pikën 9, të këtij vendimi.

23. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim, për përdorimin e llumrave të ujërave të ndotura në bujqësi, ndëshkohet sipas pikës 32, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

24. Ndalohet përdorimi në bujqësi i llumrave të trajtuara për një periudhë jo më pak se 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



25. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, QTTB-ja, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e Tokës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

#### ANEKSI IA

VLERAT KUFİ PËR PËRQENDRIMIN E METALEVE TË RËNDA NË TOKË (në mg/kg lëndë e thatë në një mostër përfaqësuese të tokave me pH nga 6 deri në 7 siç është përcaktuar në aneksin IIC)

Parametrat	Vlerat kufi
Kadmium	3
Bakër	100
Nikel	75
Plumb	200
Zink	300
Merkur	1,5
Krom	

#### ANEKSI IB

VLERAT KUFİ PËR METALET E RËNDA TË PËRQENDRUARA NË LLUMRAT QË PËRDOREN NË BUJQËSI (në mg/kg lëndë e thatë)

Parametrat	Vlerat kufi
Kadmium	30
Bakër	1 000
Nikel	400
Plumb	800
Zink	3500
Merkur	20
Krom	

#### ANEKSI IC

VLERAT KUFİ PËR SASINË E METALEVE TË RËNDA QË MUND TË SHTOHEN ÇDO VIT NË TOKË BUJQËSORE, BAZUAR NË MESATARE NË 10 VITEVE (kg/ha/vit)

Parametrat	Vlerat kufi
Kadmium	0,15
Bakër	12
Nikel	3
Plumb	15
Zink	30
Merkur	0,1
Krom	

#### ANEKSI IIA

##### ANALIZAT E LLUMRAVE

1. Si rregull i përgjithshëm, llumrat duhet të analizohen të paktën çdo gjashtë muaj. Kur ndodhin ndryshime në karakteristikat e mbetjeve të ujërave të trajtuara, shpeshësia e analizave duhet rritur. Në qoftë se rezultatet e analizave nuk ndryshojnë në mënyrë sinjifikative gjatë një viti të plotë, llumrat duhet të analizohen të paktën çdo 12 muaj<sup>1</sup>.

2. Në rastin e llumrave të gjeneruara nga impiantet e trajtimit referuar në paragrafin 22 të këtij vendimi, në qoftë se analizat e llumrave nuk janë kryer 12 muaj përpara zbatimit të këtij vendimi, analiza duhet të kryhet brenda 12 muajve të zbatimit të saj, ose kur është e përshtatshme brenda 6 muajve të vendimit të autorizimit për përdorim të llumrave në bujqësi nga impiante të tilla. Autoritetet kompetente (AKM) duhet të vendosin për shpeshësinë e analizave të mëtejshme në bazë të rezultateve të analizës fillestare, të çdo ndryshimi në natyrën e ujërave të mbetur të trajtuar dhe faktorëve të tjerë përkatës.

3. Bazuar në dispozitat e paragrafit 4, analiza duhet të mbulojë parametrat e mëposhtëm:

–Lëndë e thatë, lëndë organike;

<sup>1</sup> Shpeshësia e analizave varet nga kapaciteti i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura. Për impiantet e vogla të trajtimit të ujërave të ndotura shpeshësia është një herë në vit. Për impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura mbi 500 PE shpeshësia është dy herë në vit.





– pH;  
– azot dhe fosfor;  
– kadmium, bakër, nikel, plumb, zink, mërkur, krom.

4. Në rastin e bakrit, zinkut dhe kromit, kur autoritetit kompetent i është treguar në mënyrë bindëse se ato nuk janë aspak të pranishme ose janë të pranishme në sasi të papërfillshme në ujërat e mbetura të trajtuara nga impiantet e ujërave të ndotura, autoriteti kompetent (AKM) duhet të vendosë mbi shpeshhtësinë e analizave të kryera.

#### ANEKSI IIB ANALIZAT E TOKËS

1. Kurdoherë që do të përdoren llumra të ndryshëm nga ato të impianteve të trajtimit referuar në paragrafin 22, autoritetet kompetente (QTTB) duhet së pari të sigurojnë se metalet e rënda si përbërës të tokës nuk kalojnë kufijtë e vlerave të përcaktuara në përputhje me aneksin IA. Për këtë qëllim autoritetet kompetente (QTTB) duhet të vendosin se çfarë analizash duhet të kryejnë, duke marrë parasysh të dhënat shkencore të disponueshme mbi karakteristikat e tokave dhe homogjenitetin e tyre.

2. Autoritetet kompetente (QTTB) duhet të vendosin për shpeshhtësinë e analizave të mëtejshme, duke marrë parasysh përmbajtjen e metaleve në tokë përpara përdorimit të llumrave, sasinë dhe përbërjen e llumrave të përdorur dhe çdo faktor tjetër në lidhje me të.

3. Analizat duhet të mbulojnë parametrat e mëposhtëm:

– pH  
– kadmium, bakër, nikel, plumb, zink, merkur, krom.

#### ANEKSI IIC MOSTRAT DHE METODAT E ANALIZAVE

##### 1. Mostrat e tokës

Mostrat përfaqësuese të tokës për analizë duhet normalisht të përgatiten nga përzierja e 25 mostra ndihmëse të marra nëpërmjet sondës mbi një sipërfaqe më të vogël ose të barabartë me 5 hektarë, që është shfrytëzuar në mënyrë të njëjlojtë. Mostrat duhet të merren në një thellësi prej 25 cm, me përjashtim të rasteve kur thellësia

e shtresës së punueshme të tokës është më pak se kjo vlerë; megjithatë, thellësia e marrjes së mostrave në rastin e fundit nuk duhet të jetë më pak se 10 cm.

##### 2. Mostrat e llumrave

Mostrat e llumrave duhet të merren pas trajtimit, por përpara dorëzimit tek përdoruesi dhe duhet të jetë përfaqësuese e llumrave të prodhuara.

##### 3. Metodot e analizave

Analiza e metaleve të rënda bëhet pas tretjes në acid të fortë. Metoda e referencës së analizës duhet të jetë ajo e spektroskopisë së absorbimit atomik. Kufiri i dedektimit për çdo metal nuk duhet të jetë më i madh se 10% i kufirit të vlerës së duhur.

#### VENDIM

Nr. 128, datë 11.2.2015

#### PËR CAKTIMIN E DISA ANËTARËVE TË BORDIT TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, sipas shkronjave “dh”, “ë”, “p” dhe “g”, të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, si më poshtë vijon:

a) Z. Shpëtim Nazarko, person publik nga fusha e medias;

b) Përfaqësues shkencorë të fushave të ushqimit, ushqimit për kafshë, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve:

- Prof. Dr. Renata Kongoli (pedagoge në UBT, fusha e ushqimit);

- Prof. Dr. Dhimitër Rrapti (pedagog në UBT, fusha e veterinarisë);

- Prof. As. Dr. Lindita Molla (pedagog, fusha e sigurisë ushqimore);

- Prof. Dr. Lumturi Papa (pedagoge në UBT, fusha e ushqimit të kafshëve);

- Prof. Dr. Kapllan Sulaj (pedagog në UBT, fusha e ushqimit).



c) Znj. Nikoleta Dervishi përfaqësuese e shoqatave të konsumatorëve;

ç) Z. Agim Rameta, përfaqësues i shoqatave të agrobiznesit.

2. Vendimi nr. 321, datë 5.5.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e disa anëtarëve të bordit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

### VENDIM

Nr. 129, datë 11.2.2015

## **PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KOMUNA E PARISIT - RRUGA E RE TIRANË - ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Komuna e Parisit - Rruga e Re Tiranë - Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4 345 (katër mijë e treqind e dyzet e pesë) m<sup>2</sup>, dhe me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 37 051 988 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

Faqe | 1166

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 37 051 988 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP-ja”, të likuidohen për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS "UNAZA E MADHE TIRANË"  
SEGMENTI "KOMUNA E PARISIT -RRUGA E RE TIRANË ELBASAN"

Nr.	PRONARI			Z.K	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sip. (m <sup>2</sup> )	Çmimi (l/m <sup>2</sup> )	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	AGIM	ISLAM	ALLA	3292	100/4	Arë	898	8,528	7,657,695	Konfirmuar ZVRPP
2	RAMAZAN	ISLAM	ALLA	3292	101/28	Vresht	1159	8,528	9,883,373	Konfirmuar ZVRPP
3	HAKI	ISLAM	ALLA	3292	101/29	Vresht	1074	8,528	9,158,535	Konfirmuar ZVRPP
4	NUREDIN	ISLAM	ALLA	3292	101/45	Vresht	1214	8,528	10,352,385	Konfirmuar ZVRPP
	Shuma						4345		37,051,988	

## VENDIM

Nr. 130, datë 11.2.2015

